

**PROCESVERBAL
NGA SEANCA E XI E KUVENDIT TË KOMUNËS SË TUZIT
MBAJTUR MË 27. DHJETOR 2019.**

Seancën e hapi kryetari i Kuvendit me fillim në ora 13:30 minuta.

Në fillim të seancës është bërë konstatimi i dorëheqjes së këshilltares Albina Dreshaj, ndërsa mandati në bazë të Raportit të Komisionit Komunal të Tuzit i kalon kandidates Elizabeta Camaj.

Gjithashtu, është konstatuar dorëheqja e zëvendës kryetarit të Komisionit Komunal Zgjedhor të Tuzit, Xheneta Pepiq.

Sekretari i Kuvendit ka bërë evidencën e pranisë për këshilltarët, ku munguan: Haxho Dresheviq, Samra Gjokoviq, Naser Krkanoviq dhe Halil Dukoviq.

Krahas këshilltarëve, në seancë morën pjesë:

Nik Gjeloshaj, kryetar i Komunës;

Ivan Ivanaj, nënkryetar i Komunës;

Haris Ramoviq, nënkryetar i Komunës;

U.D. Marina Ujkaj, Sekretare e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale;

U.D. Ismeta Gjoka, Sekretare e Sekretariatit për bujqësi dhe zhvillim rural;

U.D. Lekë Ivezaj, Sekretar i Sekretariatit për planifikim dhe rregullim hapësinor dhe punë komunale;

U.D. Emin Haxhi, Sekretar i Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik,

U.D. Nikollë Camaj, Drejtor ekzekutiv i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Komunalno/Komunalet”;

U.D. Rexhep Çunmulaj, U.D. Kryeshef i shërbimit të Policisë dhe inspektionit komunal.

Kryetari i Kuvendit konstatoi kuorumin dhe plotësimin e kushteve sipas Rregullores që Kuvendi të sjellë vendime fuqiplota.

Para prezantimit të rendit të ditës, është propozuar plotësimi i tij nga e kryetarit të Komunës me dy pika, propozim të cilin e arsyetoi vetë ai.

Kuvendi me votat e këshilltarëve të pranishëm miratoi rendin e ditës në vijim:

Rëndi i ditës:

1. Propozimi i Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2020;
2. Propozim Vendimit mbi miratimin e Planit aksionar lokal për të rinjtë për periudhën 2020-2021;
3. Propozimi i Vendimit mbi tatim në patundshmëri.
4. Propozim i Vendimit mbi kriteret e hollësishme për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore rrjedhëse dhe të përhershme nga rezerva e Buxhetit, ,
5. Propozim mbi kompensimin vjetor për shfrytëzimin e hapësirës për objektet e paligjshme.

Punën e seancës e kanë përcjellur edhe përfaqësuesit e mediave lokale.

1. Pika e parë: Propozimi i Vendimit mbi Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2020

Sqarimet hyrëse lidhur me këtë pikë i ka dhënë Emin Haxhi , U.D. Sekretar i Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik.

Pas tij, fjalën e ka marrë kryetari i këshillit për financa, Enis Gjokaj i cili e ka prezantuar Raportin e këtij këshilli punues krahas dy amendamenteve që i ka dhënë këshilltari Samir Axhoviq si dhe dy amendamenteve nga kryetari i Komunës të cilët janë pranuar dhe janë bërë pjesë e Propozimit të Vendimit për Buxhetin.

Në diskutime morën pjesë këshilltarët:

Vaselj Berishaj, Simon Ivezaj, Samir Axhoviq, Mevludin Dizdareviq, Enis Gjokaj, Sanda Zejniloviq, Mirza Pepiq, Adnan Pepiq, Gjergj Camaj, Elvir Kajosheviq, Senad Gilaj, pastaj U.D. Sekretari Emin Haxhi dhe kryetari i Komunës Nik Gjeloshaj. Pas diskutimeve, është kaluar në votim.

Kuvendi ka miratuar Propozimin e Vendimit për Buxhetin e Komunës së Tuzit për vitin 2020 me këtë votim:

Votuan:21

Pro: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

2. PIKA E DYTË - Propozim Vendimit mbi miratimin e Planit aksionar lokal për të rinjtë për periudhën 2020-2021

Sqarimet hyrëse lidhur me këtë pikë i ka dhënë Marina Ujkaj, U.D. Sekretare e Sekretariatit për vetëqeverisje lokale.

Në diskutim lidhur me këtë pikë morën pjesë: Simon Ivezaj.

Pas diskutimit, këshilltarët kaluan në votim:

Kuvendi miratoi Propozimin e Vendimit mbi miratimin e Planit aksionar lokal për të rinjtë për periudhën 2020-2021

Votuan:20

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim:1

3.PIKA E TRETË- Propozimi i Vendimit mbi tatimin mbi tatimin në patundshmëri.

Sqarimet hyrëse lidhur me pikën 3 dhe pikën 4 i ka dhënë U.D. Emin Haxhi U.D. Sekretar i Sekretariatit për financa dhe zhvillim ekonomik. Gjithashtu, ka propozuar që propozuesi ta tërheqë pikën e pestë për arsye se në ndërkohë nuk ka arritur pëlqimi i Ministrisë gjegjëse.

Kryetari i Këshillit për financave dhe zhvillim ekonomik Enis Gjokaj i cili e prezantoi Raportin e trupit punues për pikën e 3 të rëndit të ditës.

Në diskutim për këtë pike (3) morën pjesë: Shtjefen Camaj, Gjergj Camaj dhe kryetari i Komunës Nik Gjeloshaj.

Kryetari i Kuvendit ka dhënë pushim prej dhjetë minutash deri sa të përgatitet amendamenti i këshilltarit Shtjefen Camaj.

Pas vazhimit të seancës përfaqësuesi i propozuesit ka konstatua se pranon amendamentin e propozuar nga këshilltari Shtjefen Camaj i cili është bërë pjesë integrale e propozimit të Vendimit.

Pas diskutimit të kryer është kaluar në votim.

Kuvendi miratoi Propozimin e Vendimit mbi tatimin në patundshmëri.

Votuan: 20

Për: 20

Kundër: 0

4. PIKA E KATËRT- Propozim i Vendimit mbi kriteret e hollësishme për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore rrjedhëse dhe të përhershme nga rezerva e Buxhetit.

Nuk pati të interesuar për pjesëmarrje në diskutim lidhur me këtë pike të rëndit të ditës.

Kuvendi ka miratuar Propozimin e Vendimit mbi kriteret e hollësishme për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore rrjedhëse dhe të përhershme nga rezerva e Buxhetit.

Votuan: 20

Për: 20

Kundër:0

Abstenim:0

Në përfundim, është miratuar Procesverbali nga seanca e X e Kuvendit të Komunës së Tuzit.

Pasi që ka përfunduar puna lidhur me rendin e ditës, kryetari i Kuvendit e ka mbyllur seancën e X, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2019.
Seanca e Kuvendit është e incizuar tonikisht.

KUVENDI I KOMUNËS SË TUZIT

SEKRETARI I KUVENDIT
Nermin Alibashiq



KRYETARI
Fadil Kajoshaj

